



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Komisioni Vlerësues për Licencim të Federatave Sportive

| | |
|-------------------------------|---|
| DATË/A: | 18.01.2023 |
| REF/: | 11/ 2023 / KVLFS |
| PËR/ZA/TO: | Z. Hajrulla ÇEKU, Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| NGA/OD/FROM: | Komisioni Vlerësues për Licencim të Federatave Sportive - KVLFS |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Rekomandim për Licencim të Federatës Skitare të Kosovës- FSK |

I nderuar Ministër,

Komisioni Vlerësues për Licencimin e Federatave Sportive (KVLFS), duke u bazuar në paragrafin 1.4 të Nenit 23 (Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit), si edhe paragrafin 4 të Nenit 24 (Marrja e vendimeve dhe e drejta në ankesë) të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për Kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive; si edhe Vendimin e Ministrit Nr.82/2022 të datës 14.06.2022, me nr. të protokollit 2592/2022, Vendimin Nr.126/2022 të datës 25.08.2022, me nr. të protokollit 2592/2022-2, dhe Vendimin Nr.177/2022 të datës 30.11.2022, me nr. të protokollit 5849/2022, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të Federatës Skitare të Kosovës, konstaton se Federata Skitare e Kosovës i ka plotësuar kriteret e kërkuara për licencim, prandaj:

REKOMANDON

1. Dhënien e LICENCËS për Federatën Skitare të Kosovës - FSK.
2. Licenca i jepet FSK-së për ciklin aktual olimpik, me vlefshmëria nga data e lëshimit të licencës.

3. Federata Skitare e Kosovës obligohet që brenda 15 ditëve të punës ta njoftojë me shkrim Komisionin Vlerësues për Licencim të Federatave Sportive (KVLFS), për çdo ndryshim që bëhet në dokumentacionin zyrtar të FSK-së dhe anëtarëve të saj, pas datës së marrjes së licencës zyrtare nga MKRS, për sa i takon çështjeve në vijim:
 - a. Ndryshimeve në Statutin e FSK-së dhe ndryshimeve në Statutin e organizatave që janë anëtare të FSK-së;
 - b. Ndryshimeve në strukturat udhëheqëse të organizatave sportive (Kryetari, Sekretari, dhe Anëtarët e Bordit Drejtues/Ekzekutiv);
 - c. Ndryshimi i përfaqësuesit të autorizuar të organizatave sportive;
 - d. Kur anëtarësohen klube/shoqata të reja në Federatë, dhe kur bëhet shuarja/largimi nga anëtarësia prej Federatës.

4. Obligohet Federata Skitare e Kosovës që 90 ditë nga data e dhënies së licencës të bëjë plotësimin e të gjithë dokumentacionit për anëtarët e saj që nuk i kanë plotësuar kriteret sipas Udhëzimit Administrativ 03/2015 për Themelimin dhe Regjistrimin e Klubeve Publike dhe Private të Sportit, si dhe Udhëzimin Administrativ 01/2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Themelimit, Licencimit dhe Ri-vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive.

5. Federata Skitare e Kosovës është obliguar që të ndërmarr masa përkatëse ndaj anëtarëve të saj që nuk përmbushin kriteret e anëtarësimit sipas dispozitave ligjore: Ligji për Sport Nr: 2003/24, Udhëzimit Administrativ 03/2015 për Themelimin dhe Regjistrimin e Klubeve Publike dhe Private të Sportit, si dhe Udhëzimin Administrativ 01/2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Themelimit, Licencimit dhe Ri-vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive, si dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore të Federatës. Për anëtarët e Federatës Skitare të cilët nuk i plotësojnë kriteret për anëtarësim në Federatë, ju ndalohet përfitim sipas dispozitave të Ligjit Nr: 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe çdo mbështetje të ngjashme nga fondet publike.

6. Në rastin se Federata Skitare nuk vepron përkitazi sipas pikës 5, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit respektivisht Komisioni Vlerësues për Licencim të Federatave Sportive do të rekomandojë për revokimin e licencës.

7. Pjesë e këtij rekomandimi është lista me emrat e anëtarëve të Federatës Skitare që i kanë plotësuar kriteret, si edhe lista me emrat e anëtarëve të Federatës Skitare që deri në datën e dhënies së këtij rekomandimi **nuk i kanë** plotësuar kriteret. Federates Skitare të Kosovës duhet të sjell dokumentacionin plotësues për anëtarët e saj, që është kërkuar nga KVLFS, deri me datën 19 Prill 2023.

Lista e anëtarëve të Federatës Skitare që i kanë plotësuar kriteret për licencim

| Nr. | Emri i klubit sportiv | Qyteti/Komuna | Përfaqësuesi i Autorizuar |
|-----|---------------------------------------|---------------|---------------------------|
| 1. | <i>Klubi i Skitarisë Prishtina në</i> | Prishtinë | Bujar Hoxha/ Kryetar |

| | | | |
|----|----------------------------------|-----------|-------------------------|
| | <i>Prishtinë</i> | | |
| 2. | <i>Klubi i Skitarisë Rusolia</i> | Pejë | Gazmend Loshi-Sekretar |
| 3. | <i>Ski Club Borea</i> | Pejë | Ernest Sefaj- Kryetar |
| 4. | <i>Klubi i Skitarisë Argjena</i> | Dragash | Xhevxhet Arifi-Kryetar |
| 5. | <i>Klubi i Skitarisë Priski</i> | Prishtinë | Rona Kokaj-Kryetare |
| 6. | <i>Klubi i Skitarisë PROone</i> | Prishtinë | Visar Kryeziu- Kryetar |
| 7. | <i>Klubi i Skitarisë Peja</i> | Pejë | Muhamet Dresha-Kryetar |
| 8. | <i>Klubi i Skitarisë Nici</i> | Obiliq | Mentor Maloku - Kryetar |
| 9. | <i>Klubi i Skitarisë ALPI</i> | Pejë | Shyqri Mema- Kryetar |

Lista e anëtareve të Federatës Skitare që NUK i kanë plotësuar kriteret për licencim

| Nr. | Emri i klubit sportiv | Qyteti/Komuna | Përfaqësuesi i Autorizuar |
|------------|--------------------------------|----------------------|----------------------------------|
| 1. | Klubi i Skitarisë KIKA | Kamenincë | <i>Imer Thaqi</i> |
| 2. | Klubi i Skitarisë Universiteti | Prishtinë | N/A |
| 3. | Klubi i Skitarisë Rugova | Pejë | N/A |
| 4. | Klubi i Skitarisë Trepça | Mitrovicë | N/A |
| 5. | | | |

Komisioni Vlerësues për Licencim të Federatave Sportive:

Fidan Shatri, Kryesues *Fidan Shatri*

Fatmir Kabashi, Anëtar *Fatmir Kabashi*

Egzontina Thaçi, Anëtare *Egzontina Thaçi*

Jehona Bashota, Anëtare *Jehona Bashota*

Blerina Imeri, Anëtare _____

Rekomandimi i KVLFS-së i dërgohet:

- > Zyrës së Ministrit z. Hajrulla Çeku;
- > Federatën Skitare të Kosovës
- > Departamentit të Sportit;
- > Komitetit Olimpik të Kosovës - KOK;
- > Komisionit të Sponsorizimeve në MKRS;
- > Zyrës së Arkivit në MKRS;
- > Arkivit të KVLFS-së;